



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:136433
Datë: 18.06.2024
Numri i dokumentit: 05832311

P.nr.4922/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Bujar Ahmeti, në çështjen penale kundër të akuzuarit SH.H., Komuna e Glllogocit, për shkak të veprës penale vjedhje e pyllit nga neni 358 par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.6568/18, të datës 21.11.2018, pas përfundimit të seancës së shqyrtimit gjyqësor publik me datë 18.06.2024 në prezencën e Prokurores së Shtetit Besnik Jakupi dhe të akuzuarit SH.H., në të njëjtën ditë mori dhe shpalli, ndërsa me datë 18.06.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari,

SH.H., nga babai R. dhe nëna Z., e gjinisë S., i lindur me datë ..., Komuna e Glllogocit, i martuar, me profesion bujk, i gjendjes së dobët ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i identifikuar me numër personal ...

Në kuptim të nenit 362 par.1 pika 1.1 të KPP-së,

REFUZOHET AKUZA

Sepse:

Me datë 31.08.2018, rreth orës 03:00, në Rajonin Ekonomiko Pyjor në Fushë Kosovë, në vendin e quajtur "Lugu i Fell", me qëllim të vjedhjes në pyll publik, i pandehuri ka prerë 124 trungje të llojit qarri dhe bingu, me dimensione të gjata 9.2/m., me diametër 18-20/cm., me vëllim të përgjithshëm prej 20.46/m³, me ç'rst të dëmtuarës Autoritetit Pyjor Komunal në Fushë Kosovë, i ka shkaktuar dëm në vlerë prej 2,618. €.

- Me këto veprime kishte për të kryer veprën penale *vjedhje e pyllit nga neni 358 par.2 të KPRK*.
- **Pasi që Prokurori i Shtetit është tërhequr nga akuza.**

E dëmtuara Komuna e Fushë Kosovës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Shpenzimet e procedurës penale bien ne barrë te mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

Ar sy e t i m

Rrjedha e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Prishtinë ka paraqitur aktakuzën, PP/II.nr.6568/18 të datës 21.11.2018, kundër të akuzuarit SH.H., për shkak të veprës penale vjedhje e pyllit nga neni 358 par.2 të KPRK-së.

Në shqyrtimin gjyqësor të datës 18.06.2024, Prokurori i Shtetit në kuptim të nenit 51 të KPP-së ka deklaruar se tërhiqet nga ndjekja penale për të akuzuarin SH.H., për veprën penale vjedhje e pyllit nga neni 358 par. 2 të KPRK-së, për faktin se i akuzuari me aktgjykimin P.nr.544/18 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Glllogoc, është shpall fajtor për veprën penale nga neni 358 par.2 të KPRK-së, e cila veprë penale sipas këtij aktgjykimi është kryer në kohën e njëjtë si në aktakuzën lëndore pra me datë 31.08.2018 rreth orës 03:00 dhe ka konsideruar se këtu i akuzuari nuk ka mundur të kryej dy vepra penale në të njëjtën kohë e në vende të ndryshme.

Meqenëse Prokurori i Shtetit në shqyrtimin gjyqësor është tërhequr nga aktakuza kundër të akuzuarit, gjykata në bazë dispozitës së nenit 362 par.1 nën par 1.1 të KPP-së në të cilën dispozitë shprehimisht është përcaktuar se “Gjykata merr aktgjykim me të cilin akuza refuzohet kur: 1.1 prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza nga hapja deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor”, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike

Lidhur me kërkesën pasurore juridike gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 462 par. 3 të KPP-së, ku e dëmtuarën Komuna e Fushë Kosovës, për realizmin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontestin e rregullt juridiko civil.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Konform nenit 453 par.1 të KPP-së, është vendosur që shpenzimet e procedurës penale të mbesin në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, e në bazë të nenit 362 par.1 nën par. 1.1 të KPP-së, u vendos si dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.4922/18 datë 18.06.2024

Gjyqtari i vetëm gjykues,

Bujar Ahmeti

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej tridhjetë (30) ditëve prej ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.